KUD: 37(496.51-2) "1990/1999"

Agon KRASNIQI

ARSIMI NË FERIZAJ GJATË VITEVE '90-të TË SHEK. XX

Abstrakt:
Arsimi në komunën e Ferizajt gjatë periudhës së viteve '90-të, u karakterizua me ngjarje të shumta, siç e kemi rastin me helmimet në shkolla, refuzimin e plan-programit serb nga ana e mësimdhënësve, largimi i të gjithë mësimdhënësve nga puna, lëshimin e dëftesave Republika e Kosovës (RKS) nga ana e shkollave, mësimi në shtëpi private, improvizimi i ditarëve, puna e mësimdhënësve pa pagesë dhe instalimi i sistemit të pagesës etj. Orientimi kryesor i studimit, është shpalosja e elementeve bazë që karakterizojnë këtë periudhë, duke përdorur një metodologji të qartë shkencore, kryesisht të metodës së analogjisë, me ç'rast do shpalosim edhe burime të ndryshme arkivore, që përçojnë me këtë periudhë. Qëllimi kryesor i këtij punimi është shpalosja e burimeve arkivore e periudhës së arsimit shqip në Ferizaj, gjatë viteve të '90-ta dhe interpretimi i tyre. Orientimi bazë i temës është të shpalosim elementët thelbësorë, nga periudha e helmimeve në Ferizaj, ku do përdorim dokumente të ndryshme arkivore të kohës, procesverbale etj., si dhe situatën e arsimit në komunën e Ferizajt ngaqë mësimdhënësit refuzuan punën me plan-programin serb, ku kjo ndikoi që të reflektohej si shenjë hakmarrjeje kur edhefilloi ndalja e pagave për mësimdhënësit dhe më pas dëbimi nga shkollat. Po ashtu kemi edhe punën e mësimdhënësve pa pagesë dhe fillimin e sistemit për pagesë nga kontributet e qytetarëve brenda dhe jashtë Kosovës, mësimi nëpër shtëpi private, etj. Në fund të punimit, do arrihet një pasqyrim i përgjithshëm mbi gjendjen e arsimit në komunën e Ferizajt gjatë periudhës së viteve të '90-ta.

Fjalët kyçe:
Ferizaj, helmimet, Kosovë, mësimdhënësit.

Arsimi në Ferizaj gjatë periudhës së helmimeve

Ferizaj gjatë periudhës së viteve 1990-1999, sikur çdo qytet i Kosovës, përjetoi një periudhë të vështirë në çdo sferë të organizimit shoqëror dhe politik, përfshirë këtu edhe arsimin. Në kuadër të kësaj, kjo situatë e cila manifestohej në periudhën e viteve 1990-1999, ishte një kundërpërgjigje ndaj organeve serbe të kohës. Kjo dëshmohet nga dokumente të ndryshme të kohës, si raporte, procesverbale, informacione shkollore, raporte të inspektimit, shtypi i kohës etj., të cilat dëshmojnë në lidhje me situatën e krijuar në Ferizaj gjatë kësaj periudhe. Kjo ishte pikërisht rezistenca e arsimit shqip, ndaj politikave serbe, të cilët mundoheshin ta pengonin zhvillimin e arsimit shqip, dhe ta zëvendësonin atë me plan-program serb. Kjo ndikoi që të krijohej një situatë pasigurie te prindërit shqiptarë, kryesisht kjo lidhej edhe me ngjarjen e helmimeve, ku frikësoheshin që fëmijët e tyre t'i dërgonin në shkolla e shpeshherë edhe nxënësit nga frika nuk mbanin mësim. Në informacionin e mbrëmjes ekzekutive të asamblesë së Krahinës Socialiste Autonome (KSA) të Kosovës, e paraqitur nga kryetari i mbrëmjes ekzekutive, Basri Bajrami[1] mbi situatën që ndodhte edhe në Shtime, theksohej se: *"Nxënësit e 6 paraleleleve të shkollës Zenel Hajdini dhe Nikolla Teslës u larguan nga klasa, më pas edhe 2 paralele. Sipas drejtuesit të qendrës, pavarësisht insistimit të mësuesve, nxënësit janë larguar nga klasa".*[2] Shembuj të tillë kishte edhe në komunën e Ferizajt, ku nxënësit e shkollave të ndryshme të komunës ishin larguar nga klasa si rezultat i helmit.[3]

Gjatë periudhës së viteve të '90-ta, në Kosovë u paraqitën raste të helmimit të nxënësve shqiptarë, helmime këto të cilat përmbanin helmin e quajtur Sarin Tabun, një helm që u vendosë në forma të ndryshme në shkollat e Kosovës. Në bazë të burimit arkivor, në arkivin historik të qytetit të Ferizajt, kemi raporte të ndryshme mbi situatën e krijuar në qytetin e Ferizajt gjatë kësaj periudhe, në shkolla të ndryshme siç është rasti te shkolla: QAMO

[1] Basri Bajrami, kryetar i Komunës së Shtimës gjerë në korrik të vitit 1990. Ai ishte delegat i deklaratës kushtetuese së 2 korrikut të vitit 1990 dhe delegat i kushtetutës së Kaçanikut më 7 shtator 1990. Shih: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (më tej: *ASHAK*), Fondi Koleksion Deklarata Kushtetuese e KAK 1990, Kutia 1, fl. 2-5. Deklarata Kushtetuese e Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 2 korrik 1990, Dokumenti Nr. 010-22/90.

[2] Arkivi Historik-Ferizaj (më tej: *AHF*). Fondi BVI e Arsimit Ferizaj, Rendi 2, Nr. Inventarit 3, Kutia 3. Raport i Basri Bajramit drejtuar mbrëmjes ekzekutive të KSA së Kosovës në Prishtinë, 16.03.1990. Izvršno veće skupštine Sap Kosova, Priština. Dokumenti, Ol. Br. 17/12.

[3] Tefik Ajvazi, *Mbarësitë e zhvillimit të arsimit në trevën e Ferizajt, 1941-1999*, (Ferizaj: SS, 2017), 431.

"Josip Broz Tito" (Gjimnazi i shkencave natyrore, tashmë me emrin "Kuvendi i Arbërit"), QAMO "Mosha Pijade" apo Ekonomia (tashmë me emrin "Faik Konica"), QAMO "Zenel Hajdini" apo shkolla teknike, shkolla "Boro e Ramizi" në fshatin Greme, shkolla fillore "25 Maji", shkolla fillore "Ganimete Tërbeshi", shkolla fillore "Tefik Çanga", shkolla fillore "Fazli Obrazhda" në fshatin Komogllavë, shkolla fillore "Përparimi në Lloshkobare" (tashmë me emrin "Bilall Shala"[4]), shkolla fillore "Muharrem Shemsedini", shkolla fillore "Skendërbeu" në Jezerc, shkolla fillore "Peko Tepavceviq"[5]. Gjatë kësaj periudhe u krijua një ndarje në mësim ndërmjet nxënësve serbë dhe shqiptarë. Kjo vërehet kryesisht në lëndën e gjuhës serbo-kroate. Kjo ndarje mbi baza nacionale erdhi si rezultati memorandumit serb.[6] Megjithatë kemi një tentativë, që mësimi të normalizohet, iniciativë kjo e filluar nga shqiptarët, ku në bazë të informatës së shkollës fillore "Peko Tapavceviq", theksohej se: *"Sot një delegacion i prindërve të nx. shqiptarë erdhën në drejtori dhe kërkuan që brenda dy ditësh të mbahej mbledhje me prindërit serbë dhe malazezë, me qëllim që nxënësit të mësojnë bashkërisht si më parë e jo kështu ndaras".*[7] Kjo kërkesë e filluar nga prindërit e nxënësve të shkollës fillore "Peko Tapavceviq", kishte si prioritet mospërçarjen e brendshme të klasave të shkollës, çka do shënonte përpjekjet e tyre për stabilizimin e mësimit.

Rastet e helmimit të nxënësve në komunën e Ferizajt, dëshmohen edhe nga informacionet që drejtoritë e shkollave i dërgonin qendrës për informim. Nga informata e drejtorit të shkollës, Mosha Pijade, theksohej se: *"Sot më 22.03.1990 në ndërrimin e dytë mësimi filloi në ora 13:00, mirëpo ndërkohë u paraqitën kërkesa nga nxënësit e paraleleve: III/10, III4, dhe*

---

[4] Bilall Shala (1950-1998), mësues i periudhës së viteve 1990-1998 dhe ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai do vritej më 29 gusht të vitit 1998 nga forcat serbe. Për nder të shërbimit të tij si në aspektin arsimor po ashtu edhe në atë ushtarak, në mbledhjen e mbajtur në shkollën "Përparimi-Lloshkobare", në vitin 2012, vendosët që emri i shkollës të emërohej Bilall Shala, (Arkivi i shkollës "Bilall Shala", Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë - MASHT, vendim. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët në Lloshkobare, komuna e Ferizajt emërtohet "Bilall Shala", Prishtinë, 12.04.2012. Dokumenti, Nr. 113/018).

[5] Peko Tepavceviq (1912-1943), ishte një partizan gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku familja e tij ishte vendosur si kolonizatore në Ferizaj gjatë vitit 1912, konkretisht vëllezërit Gavrilo dhe Gashi në komunën e Talinovcit në fshatin e vjetër, dhe ai më pas ishte bërë pjesë e strukturave të Partisë Komuniste Jugosllave, gjerë në vdekje (1943). Shih: Milovan Obradoviq, *Reforma Agrare dhe kolonizimi në Kosovë, 1918-1941*, (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2005), 293.

[6] Latif Nallbani, *Dhuna mbi arsimin shqip*, (Prishtinë: ETMMK, 2004), 58.

[7] AHF. F. BVI e Arsimit Ferizaj, Rendi 2, Nr. Inventarit 3, Kutia 3. Shkolla fillore "Peko Tepavceviq" Ferizaj, informatë, 05.03.1990, nr. 24.

III/11 se është duke kundërmua një erë e cila sipas nxënësve mund të hetohet nga sytë, hunda, fyti, njëfarë lloj molisje".[8] Kështu shohim një element thelbësor, se situata e krijuar solli destabilizim në sistemin arsimor në Kosovë, ku si rezultat mësimdhënësit shqiptarë nga Kosova refuzonin plan-programin serb, atëherë kundërpërgjigja serbe ishte helmimi i nxënësve nëpër shkolla. Pikërisht data 22 mars e vitit 1990, shënoi edhe fillimin e helmimeve në komunën e Ferizajt, e cila u manifestua në shkollën "Mosha Pijade"[9], apo Shkolla e Mesme e Ekonomisë dhe në shkollën "Peko Tepavceviq". Edhe nga raportimet e shtypit të kohës kemi përshkrimin e helmimit të nxënësve në shkollën "Mosha Pijade", në Ferizaj, ku raportohet për helmimin e 200 personave. Nga raportimet e shtypit të kohës me titull: "Në spitale u dërguan mbi 200 veta", theksohej se: *"Simptomat e helmimit u shfaqën në QAMO-n "Mosha Pijade", ndërkaq nxënësit u bartën kryesisht me automjete private. Lush Gjergji shprehu gatishmërinë e kishës katolike që të lërë në dispozicion shtretërit e saj".*[10] Nga ky pohim shohim se ishte pikërisht një organizimin i veçantë i personave që hedhën helmin, ngaqë helmi ishte vendosur në kohën kur nxënësit shqiptarë ishin pjesë e ndërrimit të pasdites. Në anën tjetër, rol të rëndësishëm kishte kisha katolike, e cila shprehte gatishmërinë që t'i ndihmonte të helmuarit.

Një pjesë e nxënësve të helmuar, kishin shkuar për mjekim edhe në Kaçanik, ku sipas raportimeve të shtypit të kohës, theksohet se: *"Prej orës 15:30 deri në orën 17:30 në stacionin e improvizuar të shtëpisë së shëndetit në Kaçanik, për shkak të helmimit u shtrinë 17 pacientë nga Ferizaj,... kërkuan ndihmë për shkak të kokëdhimbjeve, marramendjeve, shtrëngimeve të barkut dhe konvulsioneve të herëpashershme, si pasojë e helmimit. Deri në momentin kur po lajmërojmë, ende po paraqitën raste të reja në Ferizaj".*[11] Kjo është një dëshmi e simptomave që kishte dhuruar helmi, ku nga to shohim se nxënësit kishin kokëdhimbje, marramendje, dhimbje të barkut dhe situata të tjera të ngjashme, që u shkaktuan si rezultat i helmit që u vendos në shkolla.

Gjatë kohës së helmimit në shkollat e komunës së Ferizajt më datën 22 mars, ndodhi një situatë, e cila na bënë që të mendojmë se ishte pikërisht situata e helmimeve, ajo çka ndikoi që në atë ditë në Ferizaj të mos funksiononte Radio Ferizaji, (RF). Kjo për arsye që të pamundësohej marrja

[8] AHF. F. BVI e Arsimit Ferizaj, Rendi 2, Nr. Inventarit 3, Kutia 3. Informatë për gjendjen në QAMO "Mosha Pijade", dërguar Qendrës Informative të Sekretariatit për Veprimtari Shoqërore dhe Punë Administrative në Ferizaj, 22.03.1990. Dokumenti, nr. qp. 141.

[9] Shkolla "Mosha Pijade", është shkolla me numrin më të madh të nxënësve të helmuar në komunën e Ferizajt, një numër prej 241 personave. Shih: Ajvazi, *Mbarësitë e zhvillimit,* 433.

[10] Gazeta *Rilindja*, 23 mars 1990, f. 6.

[11] Gazeta *Rilindja*, 23 mars 1990, f. 5.

e informatave. Nga burimet që kemi, të shtypit të kohës, gazetës *Rilindja*, me titull "Radio Ferizaji pa program", theksohej se: *"Radio-Ferizaji prej dje nuk po transmeton programin e rregullt, për shkak të një dëmtimi që iu shkaktua antenës nga një automjet transportues me regjistrim të Zvornikut*. Ekipet profesionale të RTP-së* po riaftësojnë antenën".*[12] Kjo situatë bëri që të mos kemi informim atë ditë në lidhje me helmimet që u shkaktuan në shkollat e komunës së Ferizajt.

Politika serbe për destabilizimin e arsimit

Politika serbe, kishte për qëllim destabilizimin e arsimit shqip dhe kjo më pas do ndodhte edhe me dëbimin e mësimdhënësve nga shkollat. Megjithatë situata e helmimeve ishte një situatë e cila kërcënonte fuqishëm nxënësit, ku përmes saj politika serbe dëshironte t'i detyronte mësimdhënësit për pranimin e plan-programit serb. Përkundër faktit se helmimi masiv ishte në pah, në çdo qytet të Kosovës, ashtu edhe në Ferizaj, atëherë politika serbe synonte fajësimin e shqiptarëve. Kjo vërehet edhe në raportin e shkollës "25 Maji", ku theksohej se: *"Gjatë orës së dytë është alivanosur profesoresha e gjuhës dhe letërsisë shqipe, shoqja J. A. dhe katër nxënës të cilët u dërguan për ndihmë mjekësore. Këtë rast e vërejti edhe inspektori i SPB-së të Ferizajt ku inspektori Dragan Stanojkovi deshi që ta legjitimojë një qytetar, i cili gjendej afër grumbullit të nxënësve dhe sipas deklaratës së inspektorit ai merr një të rame, nga qytetari i panjohur".*[13] Ardhja e inspektoratit solli tollovi në mesin e qytetarëve, çka shkaktoi edhe një situatë të konfrontimit, megjithatë kjo mund të shihet edhe si një tentativë e inspektorit Dragan Stanojkovit që të largohej vëmendja e helmimeve.

Situata e krijuar në shkollat e komunës së Ferizajt, por edhe në komunat e tjera, ku informacionet përcilleshin përmes radiove dhe televizioneve, u krijua edhe frika te prindërit dhe nxënësit shqiptarë, për vijimin e mësimeve, kjo si rezultat i ndodhisë së helmimeve. Kjo pohohet nga dokumenti i shkollës "Mosha Pijade", nga shkresa e drejtorit Ahmet Gajtanit, i cili thekson se: *"Situata e krijuar dje në ndërrimin e pasdites ndikoi që edhe sot më 23.03.1990, në ndërrimin e paraditës nxënësit e kombësisë shqiptare*

---

* Zvorniku - qytet në shtetin e Bosnjë-Hercegovinës.
* RTP- Radio Televizioni i Prishtinës.
[12] Gazeta *Rilindja*, 23 mars 1990, f. 6.
[13] AHF. F. BVI e Arsimit Ferizaj, Rendi 2, Nr. Inventarit 3, Kutia 3. Informatë për gjendjen në Sh. F. "25 Maji", dërguar qendrës për informim në Ferizaj, 23.03.1990. Dokumenti, nr. 112/5.

me vështirësi kanë hyrë në dhoma të mësimit nga frika se mos do të helmohen. Pas fillimit të orës së parë brenda 10 minutave (në ora 7:50) u paraqitën disa raste të nxënësve se nuk e ndiejnë vetën mirë, duke u paraqitur se ndiejnë dhembje të kokës, fytit, hundës,, syve, shtangime.[14]

Kjo situatë e krijuar edhe më datën 23 mars të vitit 1990, do ishte indikator i bashkimit të solidarizimit ndërmjet Bashkësisë Fetare Islame në Ferizaj dhe asaj të Kishës Katolike. Pikërisht këto dy bashkësi fetare, bënë improvizimin e spitaleve në vendet e tyre fetare, pasi numri i të helmuarve ishte rritur deri në shifrën 300 veta, ku sipas shtypit të kohës, theksohej se: *"Në Ferizaj dje u reprizua helmimi i nxënësve. Më së tepërmi të sëmurë kishte në QAMO-n "Mosha Pijade", "Peko Tepavceviq", "Josip Broz Tito" dhe në Sh. F. "25 Maji" e "Ganimete Tërbeshi". Numri i të sëmurëve arriti në mbi 300 sish dhe për të gjithë nuk kishte vend andaj u desh të improvizohen spitale madje edhe në oborrin e Kishës Katolike dhe Bashkësisë Fetare Islame"*.[15] Kjo situatë është tregues i kontributit të veçantë të Kishës Katolike dhe Bashkësisë Fetare Islame, në lidhje me angazhimin e tyre për trajtimin e të helmuarve.

Situata e helmimeve[16] destabilizoi gjendjen arsimore. Megjithatë arsimi shqip vazhdoi rrugën që ky arsim të mos cenohej dhe të jetë elementi bazë i shtetformimit të Republikës së Kosovës. Megjithatë periudha e helmimeve ishte një kanosje që bëhej direkt ndaj shëndetit të nxënësve dhe mësimdhënësve shqiptarë, e cila ndikoi që frika të jetë e konsiderueshme. Mbi këtë pohon edhe dokumenti në fjalë i cili ndër të tjera thekson se: *"Në ndërrimin e pasditës nxënësit refuzuan të shkojnë nëpër paralele nga se kishin dëgjuar për ndodhin në Podujevë..., në oborr të shkollës u alivanosën tre nxënës, të cilët u dërguan me vetura te mjeku. Muhamet Shabani, profesori i historisë nuk e ka ndi vetën mirë dhe ka kërkuar ndihmë mjekësore në shtëpinë e shëndetit të Shtimes"*.[17] Refuzimi i shkuarjes në shkolla, ishte rritur si

---

[14] AHF. F. BVI e Arsimit Ferizaj, Rendi 2, Nr. Inventarit 3, Kutia 3. Informatë mbi gjendjen në QAMO "Mosha Pijade", dërguar Qendrës Informative të Sekretariatit për Punë Administrative-Juridike dhe Veprimtari Shoqërore në Ferizaj, 23.03.1990. Dokumenti, nr. qp. 143.

[15] Gazeta *Rilindja*, 24 mars 1990, f. 5.

[16] Simptomat e helmimeve ishin: dhimbje koke, dhimbje fyti, shtrëngim, dhimbje të syve, shtangime, temperaturë dhe në fund reagimi ishte deri te alivanosja. Helmi përmbante erëra të ndryshme, ku sipas nxënësve kishte erë parfumi dhe të çokollatave. Shih: Halim Hyseni, *E vërteta për helmimet*, (Prishtinë: Redaksia e botimeve e Partisë Shqiptare Demokristiane e Kosovës, 1996), 195.

[17] AHF. F. BVI e Arsimit Ferizaj, Rendi 2, Nr. Inventarit 3, Kutia 3. Informatë mbi gjendjen në QAMO "Zenel Hajdini", dërguar nga drejtori i qendrës Midovic Krunislav drejtuar Qendrës Informative të Sekretariatit për Punë Administrative-Juridike dhe Veprimtari

rezultat i kanosjes së jetës së nxënësve shqiptarë. Edhe nga ajo që raportohet nga shtypi i asaj kohe, theksohet se: *"Nga shënimet që arritëm t'i sigurojmë në qendrën informative të Ferizajt, vetëm në ndërresën e parë në katër shkollat fillore nga 1865 filloristë me mësim në gjuhën shqipe munguan 950 sish. Nga katër qendrat e mesme prej 1 905 nxënësish munguan 777 veta".*[18] Pas ngjarjes së parë të helmimit e shfaqur më 22 mars, tashmë ishte rritur edhe kujdesi nga ana e mësimdhënësve. Kemi rastin në shkollën QAMO "Josip Broz Tito", ku mësimdhënësit penguan një gjë të tillë, ku ndër të tjera nga raporti i drejtorit të shkollës Hajredin Sylejmanit theksohej se: *"Dje në ndërrimin e paraditës, pas orës së katërt nga ana e kujdestarëve të ditës është vërejtur se ka pasur tentime të ndezjes së qirinjve nëpër korridore, por është intervenuar shumë shpejt nga ana e profesorëve".*[19] Kjo ndërhyrje e mësimdhënësve shihet si formë se helmimi mund të shkaktohej nga ndezja e qirinjve me qëllim nga persona të paidentifikuar.

Politika serbe, mundohej të politizonte situatën e krijuar gjatë periudhës së helmimeve. Nga kjo ata propagandonin se helmimet ishin një aktrim i nxënësve shqiptarë. Përpos saj, ata mundoheshin që tashmë nxënësit shqiptarë t'i konsideronin kryengritës dhe organizatorë të lëvizjeve që shënonin destabilizimin e vendit dhe shkëputjen e shqiptarëve nga Jugosllavia. Nga burimet arkivore, theksohet se: *"Më 02. IV. 1990 në ora 8:35... në një paralele u gjetën të shënuara fjalët: Adem Demaçi, demokraci, barazi dhe të vizatuar dy gishtërinj".*[20] Nga kjo vërejmë se ngjarjet e helmimeve, masivizuan popullin shqiptar, ku kjo u manifestua edhe në komunën e Ferizajt, si rezultat i së cilës politika serbe ishte një politikë që kërcënonte arsimin shqip, territorin e Kosovës, statusin e saj dhe vetë qenien njerëzore, ngaqë helmimet ishin një akt i cili kërcënonte të gjithë ata që mendonin se duhej mësuar me plan-programin shqip e jo atë serb. Menjëherë reagimi për sloganet e vendosura në shkollën "25 Maji", do vinte nga sekretari Dragljub Amanoviq* i cili theksonte se: *"Në shkollën fillore "25 Maji", dy mësues të nacionalitetit serb kanë raportuar se në VII-3, u vu re slogani "Adem Demaçi", dhe në VII-13 në mur ishte shkruar slogani "Demokraci-Barazi", ndërsa në një bankë ishin vizatuar në tabelë shkronjat VV. Në*

Shoqërore në Ferizaj, 23.03.1990. Dokumenti, nr. qp. 40.

[18] Gazeta *Rilindja*, 28 mars 1990, f. 11.

[19] AHF. F. BVI e Arsimit Ferizaj, Rendi 2, Nr. Inventarit 3, Kutia 3. Informatë nga qendra AEMO "Josip Broz Tito", Ferizaj, 29.03.1990. Dokumenti, nr. qp. 97.

[20] AHF. F. BVI e Arsimit Ferizaj, Rendi 2, Nr. Inventarit 3, Kutia 3. Izveštaj u pohadjanja u čenika u Osnovnoj školi "25 Maj", Raport mbi gjendjen e vijimit të nxënësve të shkollës "25 Maj", 03.04.1990. Dokumenti, Nr. Br. 120/5.

shkollat "Mosha Pijade" dhe "Petko Tepavceviq", kanë kërkuar ndihmë disa nxënës, gjoja janë helmuar.[21] Raporti i Dragljub Amanoviqit ishte tendencioz, i cili ishte në bashkëpunim të ngushtë me mësimdhënësit serbë në shkolla, më pas do ia ndalonte që mësimdhënësit e gjuhës dhe letërsisë shqipe t'iu jepnin mësim në paralelet serbe të shkollës "25 Maji". Helmimet në të njëjtën shkollë vazhduan edhe më tutje, ku në raportin e 6 prillit të vitit 1990, theksohej se: *"Në shkollën fillore "25 Maji" në Ferizaj, në ndërtesën e re në dy paralele në katin e dytë u dëgjua një aromë në formë të parfumit dhe çokollatës ku pas një kohe u lajmëruan disa nxënës të alivanosur me kokëdhimbje, temperaturë në kokë dhe ftohje të duarve, ngërçe dhe duke bërtitur dhe qajtur. Në momentin kur ndodhën këto raste në shkollë ishte prezentë edhe punëtori i sigurimit të Ferizajt, inspektori Predreg Stefanoviq".*[22] Pohimi i raportit është tregues se çka shkaktonte helmi Sarin Tabun, ku për këtë ishte dëshmitar edhe inspektori i Arsimit.

Tentativa e serbëve, ishte të pengonin sa më shumë procesin arsimor. Helmimet ishin elementi kryesor i kësaj. Megjithatë përpos tyre, kemi edhe politikën serbe gjatë ndodhisë së vetë helmimeve, me të cilën serbët ishin kundër edhe ofrimit të ndihmës për nxënësit shqiptarë dhe dërgimin e tyre për intervenim te mjeku. Kjo politikë ishte si rezultat që të kemi mosregjistrim të nxënësve si të sëmurë, ngaqë mundoheshin ta paraqisnin atë si një inskinim, që në fakt ishte një akt i cili më pas do vërtetohej në simpozium e mbajtur në Kroaci. Kjo theksohet në raportin e shkollës "Josip Broz Tito", ku veçohet ndërhyrja serbe, ku ndër të tjera shkruan se: *"Pas orës së parë të gjithë nxënësit me mësim në gjuhën shqipe dolën në oborr të shkollës duke theksuar se po ndihet një aromë e pakëndshme në korridorin e katit të katërt. Profesori me mësim në gjuhën serbo-kroate, Demanjoviq Milan, i shtyrë edhe nga profesorë të tjerë në mësim në gjuhën serbo-kroate i kishte ftuar organet e sigurimit pa dijen time si drejtor,...* ata kanë tërhequr vërejtjen se *"asnjë profesor nuk guxon t'i dërgojë te mjeku me kerr e as t'ju ofroj njëfarë ndihme".*[23] Tendencioze janë edhe pohimet e drejtorit të shkollës "Peko

---

* Dragljub Amanoviq - sekretar i Kuvendit Komunal të Komunës së Ferizajt gjatë periudhës së viteve '90-të.

[21] AHF. F. BVI e Arsimit Ferizaj, Rendi 2, Nr. Inventarit 3, Kutia 3. Pokrajinski sekretarijat za narodno odbranu SAP Kosova - Priština. Raport i sekretarit të Kuvendit Komunal të Ferizajt, Dragljub Amanoviq, drejtuar Sekretariatit Krahinor për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës - Prishtinë, 02.04.1990. Dokumenti, Nr. Br. 80-2/61.

[22] AHF. F. BVI e Arsimit Ferizaj, Rendi 2, Nr. Inventarit 3, Kutia 3. Informatë nga shkolla "25 Maji", drejtuar Qendrës për Informim në Ferizaj, 06.04.1990. Dokumenti, Nr. Br. 123/5.

[23] AHF. F. BVI e Arsimit Ferizaj, Rendi 2, Nr. Inventarit 3, Kutia 3. Informatë nga qendra AEMO "Josip Broz Tito", Ferizaj, 11.04.1990. Dokumenti, nr. qp. 102.

Tepavceviq", i cili theksonte se: "*Pas përfundimit të orës së dytë, rreth orës 13:30, në oborr u mblodhën një numër gjimnazistësh apo iriqësh rrugorë dhe me gurë në duar tentuan të futeshin me forcë në shkollë. Me ndihmën e njerëzve të SPB-së dhe të milicisë arritëm t'i dëbojmë nga oborri. Stanislavov Stojne, i cili u sulmua nga irredentisti, dje ka shkuar te mjeku dhe ndodhet në pushim mjekësor".*[24] Këto pohime ishin faktor tjetër se qëllimi i politikës serbe tashmë ishte politizimi i situatës dhe të vendoseshin në pozitën se ata ishin në fakt të dëmtuarit, ku sulmoheshin nga radhët shqiptare, që në fakt ishin pikërisht helmimet, ato që sollën një situatë të re, ku shqiptarët mbronin të drejtën e tyre elementare; të shëndetit dhe arsimimit.

Kjo ngjalli edhe konfliktet ndërnacionale, ku gazeta *Rilindja*, për personin në fjalë Stanislav Stanoje-arsimtarin e gjuhës serbo-kroate të shkollës "Peko Tepavceviq"thekson edhe sulmin paraprak që kishte pasur ky i fundit. Ndër të tjera shtypi i kohës, theksonte se: *"Gjatë ditës së djeshme u krijuan edhe rrëmuja e pati edhe konflikte ndërnacionale. Rreth orës 09:00 nga persona të panjohur u sulmua arsimtari i shkollës Peko Tepavceviq, Stanislav Stanoje i cili mori lëndime dhe sipas dëshmitarëve do ta pësonte edhe më shumë po mos t'i vinin në ndihmë arsimtarët shqiptarë".*[25] Siç pohuam edhe më lart, diferencimi nacional në kohën e helmimeve ishte shfaqur, ku arsimtarët me origjinë serbe, nuk pranonin helmimet, bashkëpunonin me inspeksionin e komunës së Ferizajt dhe ia ndalonin më pas edhe mësimin mësimdhënësve shqiptarë, në klasat ku nxënësit ishin me origjinë serbe.

Si rezultat i helmimeve, kemi kërkesën e parashtruar të komunës së Kaçanikut, që të zbuloheshin akterët e kësaj ngjarjeje, kërkesë kjo që u përkrah edhe nga ana e ferizajasve, bazuar në pikën e 6 të mbledhjes[26] me ç'rast theksohej se: *"Kuvendi i KSA të Kosovës t'i zbulojë akterët e helmimeve dhe të tejkalimit të autorizimeve të milicisë dhe të zhvillohet procedurë kundër kryerësve të këtyre veprave (pika 6) dhe kërkojmë që të transmetohet drejtpërdrejt mbledhja e Kuvendit të KSA të Kosovës të datës 20 qershor*

[24] AHF. F. BVI e Arsimit Ferizaj, Rendi 2, Nr. Inventarit 3, Kutia 3. Njoftim i drejtorisë së shkollës "Peko Tepavceviq", 27.03.1990. Dokumenti, Bp. Nr. 39.

[25] Gazeta *Rilindja*, 24 mars 1990, f. 5.

[26] Mbledhja e pestë e përbashkët e të gjitha dhomave të Kuvendit të Kaçanikut, e mbajtur më 19 qershor të vitit 1990, përmbante 7 pika. Qëllimi i mbajtjes së mbledhjes, ishte që pikat e tyre të parashtruara të realizoheshin, në mbledhjen e KK të LK të Kosovës që do mbahej më 22 qershor (shih: Gazeta *Rilindja*, 18 qershor 1990, f. 1). Megjithatë kjo mbledhje do shtyhej për një kohë të pacaktuar, (në lidhje me mbledhjen, shih: Gazeta *Rilindja*, 22 qershor, 1990, f. 1).

1990, me anë të TVP. (pika 7).”[27] Kjo kërkesë ishte iniciativë që çështja e helmimeve të zbardhej dhe të fillonte normalizimi i mësimit në shkolla.

Gjatë kësaj periudhe, sistemi arsimor në komunën e Ferizajt u konkretizua me një destabilizim të thellë, kryesisht nga 22 marsi i vitit 1990. Situata e krijuar nga helmimet ndikoi që sistemi arsimor, të merrte një pamje tjetër, pamje kjo që do zgjaste deri në vitin 1999.

Shkollat në komunën e Ferizajt, gjatë viteve ‘90-të të shek. XX.		
Sh. F. *Përparimi*	Sh. F. *Ali Hadri*	Sh. F. *Jeta e Re*
Sh. F. *Gjon Serreqi*	Sh. F. *Halit Ibishi*	Sh. F. *Imri Halili*
Sh. F. *Jeronim De Rada*	Sh. F. *Liman Reka*	Sh. F. *Besim Rexhepi*
Sh. F. *Abetarja*	Sh. F. *Ismajl Qemajli*	SHML *Çesk Zadeja*
Sh. F. *Konstandin Kristoforidhi*	Sh. F. *Skënderbeu*	SHML *Kuvendi i Arbërit*
Sh. F. *Ganimete Tërbeshi*	Sh. F. *Ramadan Rexhepi*	SHML *Faik Konica*
Sh. F. *Dituria*	Sh. F. *Visar Ddodani*	SHML *Pjetër Bogdani*
Sh. F. *Tefik Çanga* Sh. F. *Dardani*	Sh. F. *Muharrem Shemsedini* Sh. F. *Naim Frashëri*	SHML *Zenel Hajdini* SHML *Elena Gjika*

Tabela 1: Shkollat në komunën e Ferizajt gjatë viteve ‘90-të shek. XX.

Situata në sistemin arsimor të Ferizajt pas periudhës së helmimeve

Pas përmbylljes së sistemit të vitit shkollor 1989/90, tashmë kishte filluar një periudhë e re e sistemit arsimor në Kosovë. Kjo situatë e cila u manifestua edhe në komunën e Ferizajt, e vendosi në një periudhë të re sistemin arsimor, periudhë kjo e cila do manifestohej deri në vitin 1999. Pavarësisht që kjo u karakterizua me mësim nën trysnin e forcave serbe, arsimi shqip do vazhdonte tutje, ku edhe në këtë gjendje u mbajtën gara të ndryshme të diturisë dhe të sportit edhe në komunën e Ferizajt. Si rezultat i kësaj filloi edhe lëshimi i dëftesave me vulë RKS*, ku kjo u bë në mënyrë të fshehur nga forcat serbe. Megjithatë, Beogradi i njoftuar për situatën në fjalë,

---

[27] AHF. F. BVI e Arsimit Ferizaj, Rendi 2, Nr. Inventarit 3, Kutia 3. Procesverbal i mbledhjes së 5 të përbashkët e të gjitha dhomave të Kuvendit, e mbajtur nën kryesinë e kryetarit të Kuvendit Komunal të Kaçanikut, Osman Krasniqit, 19.06.1990. Dokumenti, 0/0. 55.

filloi reaksionin kundër arsimit shqip. Për këtë arsye nga Beogradi, u dërgua si drejtor i shkollës “Josip Broz Tito”, Ferizaj, Dobrivoje Staletoviq dhe në shkollën QAMO “Mosha Pijade”, Vera Stevanoviq. Nga raportimet e shtypit të kohës, mbi ngjarjen në fjalë, theksohet se: *“Dy ditë pasi u emërua nga Beogradi si drejtor i dhunshëm në gjimnazin J. B. Tito, Dobrivoje Staletoviq ia mori vulat e shkollës sekretarit Selim Jakupit. Kështu, ky drejtor që në start dëshmoi qëllimet e tij autokratike. Tentim për uzurpimin e vulave pati edhe nga drejtoresha e QAMO “Mosha Pijade”, Versa Stevanoviq, por sekretari Afrim Gashi nuk ia dorëzoi ato”.*[28] Kjo dëshmon se lëshimi i dëftesave me vulë të Republikës së Kosovës ishte i papranueshme për organet serbe, sa që një ndër arsyet për emërimin e këtyre drejtorëve në shkolla ishte edhe largimi i vulave të lëshuara nga organet e Kosovës.

Në komunën e Ferizajt, siç ndodhi edhe në komunat e tjera, filloi përjashtimi i mësimdhënësve nga puna, ku fillimisht u përjashtuan 20 mësimdhënës nga shkolla “Mosha Pijade”, dhe pastaj me vendimin e 14 shkurtit të gjithë mësimdhënësit shqiptarë.[29]

Bisedat informative në sistemin arsimor të komunës së Ferizajt

Në këto rrethana, filloi edhe shtypja e arsimit shqip nga forcat serbe, me ç’rast tashmë merreshin mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave në biseda informative, dhe tortura tjera ndaj punëtorëve të arsimit shqip. Përpos saj filloi edhe arrestimi i mësimdhënësve dhe i drejtorëve të shkollave në komunën e Ferizajt, si rezultat i refuzimit të plan-programit serb dhe protestave për hapjen e shkollave. Në mbishkrimin e shtypit të kohës, me titull “Policia dhe inspektorët penguan mbajtjen e mësimit, (u arrestuan dy drejtorë të shkollave dhe dy arsimtarë, kurse në disa shkolla milicia urdhëroi të mbyllen dyert për nxënësit shqiptarë)”, theksohej se: *“Në shkollat nëpër*

* RKS - Republika e Kosovës.
[28] Gazeta *Bujku*, 25 janar 1991, f. 11.
[29] Më 14 shkurt të vitit 1991, me vendim të fondit monetar, bëhet pezullimi nga puna i të gjithë mësimdhënësve shqiptarë. Edhe në komunën e Ferizajt u lëshua vendimi nga Sekretariati jolegjitim Komunal për veprimtari shoqërore, të cilët theksonin se shkollave iu urdhërohet, që të pranojnë plan-programin e Serbisë, pastaj të vazhdojnë procesin mësimor. Ramadan Ramadani, *Mbijetesa - arsimi shqip në komunën e Ferizajt, 1990-1999*, (Ferizaj: Intergraf, 2015), 77.
* Situata e krijuar kishte për qëllim destabilizimin e sistemit arsimor në Kosovë. Pikërisht në këtë kohë manifestohen dënime të ndryshme të Gjykatës Komunale në Ferizaj, me të cilën kemi ndëshkime të shkollave në aspektin financiar dhe personave të ndryshëm që kontribonin në arsim. Shih: Ramadani, *Mbijetesa,* 95.

fshatra: Lloshkobare, Prelez i Jerlive, Zllatar, Rahovec, Slivovë, Koshare, Prelez i Muhaxherëve, etj., me të filluar mësimi erdhën milicët dhe inspektorët jolegjitimë, të cilët detyruan nxënësit dhe arsimtarët të lëshojnë objektet shkollore. Në vendet e tyre të punës u arrestuan drejtori i shkollës fillore "Përparimi të Lloshkobares", Habib Haziri, ai i shkollës fillore "Ismail Qemali", si dhe dy arsimtarë të shkollës së Prelezit të Muhaxherëve, Shaban Plakaj dhe Sabit Ferati".[30] Situatë e njëjtë vazhdoi edhe në vitin shkollor 1992/93, ku në shkollat fillore të Zllatarit, Nerodimes, Softajt dhe Sazlis, iu ndalua hyrja në shkollë, dhe në anën tjetër drejtori i shkollës "Dituria", u arrestua nga forcat serbe, me ç'rast u konfiskuan edhe vulat me simbole RKS.

Për këtë, shtypi i kohës, raportonte se: *"Në shkollat fillore të Zllatarit, Nerodimes, Softajt dhe Sazli edhe gjatë javës që e lamë pas, drejtoritë e dhunshme serbe nuk e lejuan mbajtjen e mësimit në objektet shkollore. Policia madje mori në bisedë informative, drejtorin e shkollës "Dituria" të Tankosiqit, Hysen Ademin dhe i konfiskoi vulat e reja të kësaj shkolle, me mbishkrimin Republika e Kosovës".*[31] Në bisedën informative, ishte ftuar dhe Rasim Tasholli, rreth 12 herë, ku ky i fundit ishte drejtor i shkollës "Gjon Serreqi". Nga shënimi i shtypit të kohës, (me titull: *Një bisedë informative për të 12 herë*!), theksohej se: *"Pardje u thirr në bisedë informative në QS drejtori i shkollës fillore "25 Maji" të Ferizajt, Rasim Tasholli, për shkak të refuzimit që arsimtarët të punojnë me plan-programet e Serbisë".*[32] Kjo lloj metode e serbëve, mbi arrestimin e mësimdhënësve, marrjen e dokumentacioneve, raportohet edhe nga një shënim i KMDLNJ* - dega në Ferizaj, ku përpos kësaj, shohim edhe agresionin ushtarak në shkolla. Kjo ishte manifestuar edhe në shkollën fillore "Konstandin Kristoforidhi", në fshatin Balaj të komunës së Ferizajt, me ç'rast kemi edhe përdorimin e armëve ushtarake nga forcat serbe. Nga raportimi i KMDLNJ, theksohej se: *"Ju njoftojmë se sot më 24.06.1993, aty rreth orës 10:00, tre policë të stacionit të Nerodimes rrethuan shkollën fillore Konstandin Kristoforidhi, në fsh. Balaj, dhe me vete morën drejtorin e shkollës Fehmi Kashtanjeva, pedagogun e shkollës Shaban Rexhepin, kryetarin e pleqësisë së shkollës Sami Sadikun dhe kërkonin Kadri Aliun,...* Po ashtu, *"Policët me vete morën edhe dokumentacionin që gjetën në shkollë. Vlen të përmendet edhe kjo se policët*

[30] Gazeta *Bujku*, 23 janar 1992, f. 4.
[31] Gazeta *Bujku*, 26 tetor 1992, f. 3.
[32] Gazeta *Bujku*, 2 mars 1991, f. 16.
* KMDLNJ, apo ndryshe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, ishte një organizatë joqeveritare, e formuar më 14 dhjetor të vitit 1989 në Prishtinë. Qëllimi i këtij këshilli ishte mbrojtja e të drejtave të njeriut, ku gjatë periudhës së viteve 1990-1999, kemi informacione të shënuara nga persona përkatës, në bazë të raportimeve ditore.

si shenjë rrethimi përdorën automatikun, me të cilën gjuajtën dy herë".[33]

Ngjarje e ngjashme, vërehet po atë ditë edhe në shkollën "Halit Ibishi", në Cërnillë të komunës së Ferizajt, ku ftesat për bisedë informative, përmbanin elementin e politikës së zbulimit, për ndodhitë në shkollë ku pyetja primare ishte për vulat e lëshuara RKS. Nga raportimet e KMDLNJ për shkollën në fjalë, theksohet se: *"Sot më 24.06.1993 , në ora 10:00 erdhën në shkollën fillore Halit Ibishit në Cërnillë 4 policë, me kerr hynë në shkollë dhe në zyrën e drejtorit kontrolluan të gjithë dokumentacionin çka ishte në zyrë. Pastaj na morën në SPB mua (sekretaren Mirvete Grainca) dhe drejtorin e shkollës Enver Grainca,...* Pastaj atyre iu parashtruan pyetje në lidhje me *"vulën, kush e ka sjell, për çka përdoret, çka vulosni me të, si është fuqizuar vula".*[34] Kjo bisedë informative shihet si një mënyrë e politikës serbe për ta kontrolluar sistemin arsimor në Kosovë, ku përmes pyetjeve kishte për qëllim që t'i zbulonte informatat bazike në lidhje me vulat e lëshuara nga Republika e Kosovës. Si rezultat i qëndresës së mësimdhënësve shqiptarë, filloi edhe dënimi nga Gjykata Komunale e Ferizajt, si rezultat i kundërshtimit për mbylljen e shkollave në komunën e Ferizajt. Kjo u manifestua edhe në fshatin Greme, ku në gazetën "Bujku" theksohej se: *"Gjykata Komunale e Ferizajt dënoi me 60 ditë burg drejtorin e shkollës fillore të Gremes, Ismet Misini, për shkak se kundërshtoi mbylljen e shkollës për nxënësit shqiptarë. Po për këtë arsye kjo gjykatë dënoi me 50 ditë edhe arsimtarin, Sahit Ferati".*[35] Kjo tregon edhe ndëshkimet ndaj drejtorëve që rezistuan në mbylljen e shkollave, ku si masë ndëshkuese nga ana e organeve serbe ishte edhe burgimi i drejtorëve dhe mësimdhënësve.

Mbyllja e shkollave dhe mbajtja e mësimit në shtëpi private. Puna e mësimdhënësve pa pagesë dhe instalimi i sistemit të pagesës nga Qeveria e Kosovës

Forcat serbe, urdhëruan mbylljen e shkollave fillore dhe të mesme, megjithatë më vonë shkollat fillore do ktheheshin në objektet shkollore, për dallim nga shkollat e mesme që vazhduan procesin mësimor. Numri i objekteve të shkollave fillore që u mbyllën në komunën e Ferizajt ishte

---

[33] Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (më tej: KMDLNJ). Fondi Raportimet e vitit 1993-1994, informatë e sekretariatit të shkollës, 24.06.1993. Dokumenti, A1.13 A1.04 A1.29 A0.02.00.

[34] KMDLNJ, F. Raportimet e vitit 1993-1994, informatë e sekretareshës së shkollës, Mirvete Grainca, 24.06.1993. Dokumenti, A1.04 A1.13 A1.08 A0.03.03.

[35] Gazeta *Bujku*, 24 janar 1991, f. 10.

dymbëdhjetë.[36] Megjithatë shkollat gjatë periudhës së vitit 1991, u mbyllën edhe për 15 mijë filloristët ferizajas. Kjo dëshmohet edhe nga shtypi i kohës, ku theksohej se: "*Pas një strategjie perfide gjatë dy-tri ditëve të para, ku pati hyrje të milicisë nëpër shkolla, arrestime të arsimtarëve, drejtorëve, madje edhe të prindërve, pushteti serb i mbylli dyert për 15 mijë fillioristë ferizajas"*.[37]

Kjo bëri që mësimi të kthehej në shtëpi private, si rezultat i mbylljes së shkollave[38], ku sipas shtypit të kohës, (me titull: *Mësimi, mbahet në shtëpi private - pas mbylljes së shkollave për filloristë të Ferizajt*), theksohej se: *"Pushteti serb përmes një strategjie tejet agresive i mbylli dyert e shkollave për filloristët shqiptarë të komunës së Ferizajt. Megjithëkëtë, sipas informacioneve të pakta që morëm nga terreni mësimi edhe sot po mbahet, por nëpër punkte dhe shtëpi private"*.[39] Përpos mbylljes, u instalua edhe inspektimi nga forcat serbe, ku inspektonin situatën se mos ka ndonjë rast, që shkollat e mesme mbajnë mësim në objektet e shkollës fillore.[40] Kësi lloj inspektimi kemi edhe në fshatin Dremjak, të komunës së Ferizajt, me ç'rast, nga raportimet e KMDLNJ, theksohej se: *"Më 22.11.1994 rreth orës 09:10, dy policë të armatosur të stacionit policor të Nerodimes, hynë në oborrin e shkollës fillore "Konstandin Kristoforidhi", paralelja e ndarë në Dremjak, ku po zhvillohej ora e edukatës fizike...* Pas saj filluan edhe provokimet ku, *"Policët hynë në sallën e mësimdhënësve dhe provokuan arsimtarin Osman Muhaxherin duke i thënë se duhet përshëndetur duke i ngritur tre gishtërinjtë lart. Policët i kontrolluan edhe ditarët e punës dhe u larguan"*.[41] Kjo formë

---

[36] Musli Marevci, *Fatet e shkollës shqipe nëpër vite*, (Ferizaj: Intergraf, 2012), 266.
[37] Gazeta *Bujku*, 26 janar 1992, f. 3.
[38] Kundërpërgjigja e Pleqësisë së Arsimit të Kosovës, ishte ndryshimi i emrave për shkolla. Kjo u manifestua edhe në komunën e Ferizajt, ku emri i shkollës së gjimnazit shkencor, i quajtur "Josip Broz Tito", u zëvendësua me "Kuvendi i Arbërit", shkolla "Milan Milaniq" u zëvendësua me emrin "Dituria", shkolla "25 Maji", me "Gjon Serreqi", shkolla "Peko Tepavceviq" me emrin "Jeronim de Rada", shkolla "Vuk Karagjiq", me emrin "Konstandin Kristoforidh", shkolla "Milan Zeqar", me emrin "Abetarja", shkolla "Mosha Pijade", me emrin "Faik Konica", qendra teknike me emrin "Pjetër Bogdani". Ky ndryshim i emrave ishte kundërpërgjigja e pleqësisë së arsimit, ku rezultoi edhe me një kujtesë historike, mbi ngjalljen e elementëve kombëtare në arsimin shqip. Shih: Ramadani, *Mbijetesa*, 165.
[39] Gazeta *Bujku*, 23 janar 1992, f. 3.
[40] Pas një periudhe që mësimi u mbajt në shtëpi private, nga filloristët, nga periudha e vitit 1992 fillon mësimi në shkollat e tyre vetëm për filloristët. Nga kjo situatë, në mënyrë të fshehtë u mbajt mësimi nga mësimdhënësit e shkollave të mesme, në objektet e shkollave fillore, përpos mësimit që mbahej në shtëpi private. Shih: Ramadani, *Mbijetesa*, 166.
[41] KMDLNJ, F. Raportimet e vitit 1993-1994, informatë e Rexhep Muhaxherit, 22.11.1994. Dokumenti, A1.04, A1.06.

e provokimit nga policia serbe ishte një mënyrë e pengesës së arsimit shqip në këto vite.

Pavarësisht këtyre rrethanave, mësimi vazhdoi në shtëpi private[42], me ç’rast në anën tjetër filloi lëvizja për mbrojtjen e shkollës shqipe nga politika serbe, lëvizje kjo e filluar në Ferizaj nga Forumi i Gruas, ku krijuan një peticion, që deri më datën 12 janar arriti 50 mijë nënshkrime, vetëm në komunën e Ferizajt dhe të Shtimes, ku në këto rrethana paraqiten kërkesat e tyre për mbrojtjen e shkollës shqipe dhe të drejtën e shkollimit në gjuhën shqipe. Peticioni i Forumit të Gruas në Ferizaj u prezantua edhe në shtyp, ku theksohej se: *“Peticionin e nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve shqiptarë, të cilin Forumi i Gruas i LDK-së do t’i dërgojë UNESCO-s dhe OKB-së, e në të cilin kërkohej mbrojtja e shkollës shqipe nga politika diskriminuese e inkuizitive e ekspanzionizmit serb, vetëm në komunat e Ferizajt dhe të Shtimes, e nënshkruan mbi 50 mijë nënshkrues,...* Nga ky peticion *“kërkohej që me ngulm të angazhohen, në mënyrë që edhe nxënësit e studentët shqiptarë të gëzojnë të drejtën e shkollimit në gjuhën amtare, e drejtë kjo që garantohet me të gjitha konventat ndërkombëtare, e që respektohet në të gjitha shtetet e civilizuara veç këtij totalitar e policor serb”.*[43] Kërkesa ishte pasqyrim i situatës aktuale në Ferizaj dhe një formë e angazhimit nga forumi i grave.

Kjo periudhë u manifestua edhe me punën e mësimdhënësve pa pagesë, me ç’rast kjo ndikoi që fokusi kryesor të ishte shkollimi i nxënësve, që popullsia e Kosovës të mbrohej nga fatkeqësia e analfabetizmit. Nga kjo, filloi edhe mobilizimi i popullit brenda dhe jashtë Kosovës, ku me ndihmën e tyre u bë edhe sistemi i pagesave për mësimdhënësit, me ç’rast nisi me 20 marka gjermane dhe u rrit deri në 100 marka, në periudhën e vitit 1997-1998. Kjo gjendje solli mobilizimin e popullsisë së Ferizajt, ku siguruan mjete për arsimtarët, mjete këto simbolike, si dhe mjete për largimin e shpenzimeve të udhës për mësimdhënësit që udhëtonin. Nga informacionet që kemi nga shtypi mbi këtë situatë, theksohet se: *“Duke parë pozitën e rëndë të arsimtarëve dhe pengesat me të cilat po ballafaqohen nxënësit shqiptarë në rifillim të këtij viti shkollor, banorët e lagjes së gjashtë të rajonit numër katër të Ferizajt, për tri ditë grumbulluan 1 140 franga zvicerane, 820 marka gjermane, 28 mijë dinarë, 600 fletore për nxënës si dhe 50 kompas e*

---

[42] Mësimi në shtëpi private zhvillohej bazuar në planet mësimore të Entit Pedagogjik të Kosovës, ku këta të fundit e kishin hartuar planin me variante dhe nënvariante të kushteve të jashtëzakonshme. Kjo formë e planeve shënonte edhe sistemin e pavarur arsimor, që përfshinte vitet 1990-1999. Shih: Ragip Gjoshi, *Mësimdhënia e Gjuhës Shqipe në Kosovë aspekte historike dhe didaktike,* (Prishtinë: Armagedoni, 2016), 251.
[43] Gazeta *Bujku*, 12 janar 1992, f. 4.

pesëdhjetë trekëndësha, të cilat ia ofruan shkollës fillore "Ganimete Tërbeshi" të këtij qyteti,... Në anën tjetër *"Edhe fshatarët e Kosharës* tubuan 25 mijë dinarë, për t'ua hequr shpenzimet arsimtarëve udhëtarë të shkollës fillore "Përparimi"".*[44] Ky mobilizim i qytetarëve, ishte një ndihmesë për mësimdhënësit që punonin në kushte të rënda.

Pavarësisht kushteve, studentët e Ferizajt arritën të marrin bursë, me ç'rast vlen të theksohet se këto bursa ishin një ndihmesë nga qytetarët brenda dhe jashtë Kosovës. Nga raportimet e gazetës "Bujku", (me titull: *Studentëve të dalluar - 11 bursa të solidaritetit*"), theksohej se: *"Të shtunën e kaluar me një solemnitet rasti u finalizua me sukses nisma e Korrespodenturës së "Bujkut", gjegjësisht "Rilindjes" dhe RTV "Zëri i Kumanovës" në Ferizaj për ndarjen e bursave të solidaritetit për studentët e dalluar në studime e me gjendje të rëndë materiale. Gëzon fakti se të gjithë bursëkërkuesve iu nda kjo ndihmë në shumë mujore prej 70 markash gjermane dhe se mesatarja e notës së përbashkët arrin në 8,45".*[45] Angazhimi i studentëve dhe ndarja e bursave në gjendje të jashtëzakonshme është faktor thelbësor i suksesit të përbashkët të mësimdhënësve, nxënësve, studentëve dhe qytetarëve.

Ndihma ndaj sistemit arsimor në Kosovë, ishte prioritet elementar i popullsisë. Kjo vërehet edhe në Ferizaj, ku si rezultat i mungesës së inventarit në gjimnazin "Kuvendi i Arbërit", kemi mobilizimin e prindërve, për realizimin e projektit. Nga e përditshmja "Bujku", (me titull: *Prindërit ndihmuan Gjimnazin "Kuvendi i Arbërit"*[46]*, në Ferizaj, për inventar 2 500 marka*), theksohej se: *"Pas shprehjes së shqetësimeve të drejtorit Halim Thaçi, për gjendjen e rëndë në të cilën ndodhet procesi mësimor, si pasojë e mungesës së inventarit mësimor, gjatë një tubimi të drejtorisë së shkollës "Kuvendi i Arbërit", me prindërit e nxënësve, këta të fundit, tubuan 2 500*

* Në këtë periudhë, banorët e Kosharës, Slivovës dhe Tërrnit, ishin pjesë e shkollës "Përparimi", në Lloshkobare. Nga viti 1997, do pavarësohej shkolla e Kosharës, ku emërtohet me emrin "Dëshmorët e Kosharës". Shih: Ramadani, *Mbijetesa*, 586.

[44] Gazeta *Bujku*, 9 shkurt 1992, f. 5.

[45] Gazeta *Bujku*, 1 shkurt 1995, f. 5.

[46] Emërimi i shkollës gjimnazi "Kuvendi i Arbërit", erdhi si rezultat i kujtesës historike të ngjarjes së Kuvendit të Arbërit. Ky kuvend ishte mbajtur më 14-15 janar të vitit 1703, i cili ishte mbledhur me urdhër të Papa Klementit XI. Si udhëheqës të kuvendit kishte zgjedhur kryeipeshkun e Tivarit. Elementet përmbajtësor, përpos atyre papale, ishin edhe kombëtare, si pjesë e identitetit të shqiptarëve. Duke e pasur parasysh këtë kujtesë historike, shkolla u emërua me emrin "Kuvendi i Arbërit", për dallim që më parë e kishte emrin "Josip Broz Tito", për shkak të presidentit të Federatës Jugosllave, Josip Broz Tito. Shih: Ramadan Deli Ramadani, *Gjimnazi "Kuvendi i Arbërit" - Ferizaj 1967-2007*, (Ferizaj: Intergraf, 2007), 180.

marka për plotësimin e nevojave të ngutshme të kësaj themelate të arsimit.[47] Kjo dëshmon angazhimin e përgjithshëm dhe solidarizimin e qytetarëve në rrethana lufte.

Situata e krijuar, manifestohet edhe me zhdukje dhe vrasje. Më poshtë paraqesim statistikat e vitit 1998 për arsim, mbi të zhdukurit dhe të vrarët në komunën e Ferizajt, në sektorin e arsimit.

Ferizaj	Nxënës	10
	Sh. fillore	23
	Sh. mesme	16
	Arsimtarë	4
	Studentë	6
		59

Tabela 1: Të vrarët nga forcat serbe, gjatë vitit 1998, në sektorin e arsimit.[48]

Ferizaj	Sh. mesme	2
	Sh. fillore	2
	Studentë	1
	Nxënës	2
		7

Tabela 2: Të zhdukurit nga forcat serbe, gjatë vitit 1998, në sektorin e arsimit.[49]

[47] Gazeta *Bujku*, 9 nëntor 1996, f. 3.
[48] KMDLNJ, Raport i lëshuar nga ish-kryetari i NKMDLNJ, dega në Ferizaj, Lumni Salihu, 04.01.2023.
[49] KMDLNJ, Raport i lëshuar nga ish-kryetari i NKMDLNJ, dega në Ferizaj, Lumni Salihu, 04.01.2023.

Agon KRASNIQI

SUMMARY

EDUCATION IN FERIZAJ DURING THE 1990-s

During the 1990-s, education in Ferizaj faced numerous challenges that spanned during a decade timeframe. The onset of hostilities on March 22, 1990 marked a pivotal turning point for schools in Ferizaj and throughout Kosovo. The first reported case of disturbances-poisoning of Albanian children, occurred at “Peko Tepavcevic” and “Mosha Pijade” schools and quickly sparked a wave of national uprising in Ferizaj. In response, the Serbian government employed tactics of apartheid such as forcing the separation of Albanian schooling and withholding of Albanian teacher salaries, effectively obstructing Albanian education and fueling further dissent. Along with the closure of schools, there were also pressure to the teachers by the serb Secret Security Forces, employing forced information meetings.

In 1992 primary schools resumed schooling their public buildings, however secondary schools in Albanian were separated and force to develop education in private premises. Meanwhile, the Kosovo Trustee Council of Education made a decision to rename schools in Kosovo, aimed at reflecting their cultural and historical identity of Kosovo Albanians. Serbian authorities further exacerbated the tension by trying to impose their curriculum upon Albanian educators, leading to a strong backlash from the teachers who refused to accept this decision. The educational system in Albanian language in Kosovo was organized independently by the Government of Kosovo in exile. Not only did this situation cause upheaval, but it also resulted in the loss of lives and vanishings within the teaching education sector. According to KMDLNJ’s findings, 59 individuals were killed and 7 went missing in the Ferizaj region during the tumultuous year of 1998. Despite the excessive violation of humane right for education of Albanian children in Ferizaj and in Kosovo over one decade, the unwavering commitment and perseverance of teaxhers and others in the municipality of Ferizaj ensured the survival of Albanian education.